

VENDIM
Nr. 95, datë 2.4.2026

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s,
LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SHPK PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE TË SAJ SI MJET PËR
GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ “RAIFFEISEN BANK” SHA**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 46/12 prot., datë 1.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni, si vijon:

1. Fillimi i procedurës për transferimin e aseteve

- Shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 237, datë 22.9.2022, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për centralin fotovoltaiik me kapacitet 10 mw, me vendndodhje në Dërmenas, Bashkia Fier, qarku i Fierit.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 342, datë 23.12.2025, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë për marrjen e autorizimit për vendosje kolateral asetet fikse të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Procedura vijuese dhe vlerësimi i dokumentacionit

- Pas analizimit/vlerësimit të dokumentacionit të përcjellë nga ana e shoqërisë, në kuadër të aplikimit, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 67, datë 2.3.2026, vendosi të përfundojë procedurën e nisur me vendimin nr. 342/2025, në lidhje me tre kontratat e kredisë të datave 19.4.2021, 13.10.2021 dhe 24.8.2022 (pasi janë nënshkruar përpara licencimit të shoqërisë nga ERE), si dhe të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. për marrjen e autorizimit për transferimin e aseteve fikse, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a., në lidhje me kontratën e kredisë nënshkruar në datën 2.9.2025.

- Për sa më sipër, u vlerësua mbajtja e një seance dëgjimore e cila u zhvillua në datën 17.3.2026, me përfaqësuesit e shoqërisë dhe “Raiffeisen Bank” sh.a., me qëllim sqarimin e nevojës së kredisë, në kushtet kur centrali është tashmë i ndërtuar dhe ka hyrë në prodhim, si dhe objektin për të cilin kjo kredi është dhënë.

- Në këtë seancë u trajtua pjesa e ndarjes së listës së aseteve, si dhe u bënë sqarimet përkatëse në lidhje me objektin, pasi shoqërisë i është nevojitur financim për veprimtari të tjera që nuk lidhen me atë të licencuar nga ERE, por në referencë të ligjit nr. 43/2015 dhe rregullores, duhet të bëhet ndarja e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar, në kuadër të garantimit të shlyerjes së kredisë së nënshkruar më datë 2.9.2025.

- Në lidhje me sa evidentuar, nevojitet koha për korrespondencën përkatëse me shoqërinë dhe me bankën për të dokumentuar listën përkatëse të rishikuar të aseteve fikse të centralit,

bashkëlidhur kontratës së kredisë, datë 2.9.2025, me anë të të cilave do të garantohet shlyerja e detyrimit kundrejt bankës financuese.

3. Zgjatja e vendimmarrjes së Bordit

- Referuar nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me qëllim depozitimin e listës të rishikuar të aseteve fikse, referuar kontratës së nënshkruar më datë 2.9.2025, vlerësohet zgjatja me 60 (gjashtëdhjetë) ditë e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. për transferimin e aseteve fikse të saj. Shoqëria dhe banka duhet të depozitojnë këtë listë në ERE brenda 40 (dyzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Brenda 40 (dyzet) ditëve duhet të depozitohet në ERE lista e rishikuar e aseteve fikse, referuar kontratës së nënshkruar më datë 2.9.2025.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k. dhe “Raiffeisen Bank” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti